

Komuna e Podujevës

Nr. 5

Podujevë, datë 12.06.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi i parë i Kornizës Afatmesme Buxhetore për buxhetin 2027-2029 të Komunës së Podujevës.

Salla e Kuvendit të Komunës

Mbajtur me datë 12 qershor 2026 nga ora 18:00.

Të dhënat e përgjithshme

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Podujevës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 20/06/2026 në emalin arbnore.uka@rks-gov.net ; liridona.rrahmani@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Podujevës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverballi ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmbanë të dhëna për fazën përgaditore të dëgjimit përmbledhjen na takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit

Veprimet para nisjes së takimit:

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre.

Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Zhvillimet gjatë takimit:

Takimi ka nisur në ora 18:05 të pranishëm ishin drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Arbnora Uka, anëtarja e grupit punues Liridona Rrahmani. Nga qytetarët morën pjesë 2 qytetarë gjithsej.

(Shih aneks Fotografi nga takimi, shih në aneks listën e pjesëmarrësve)

Fjalimi hyrës i drejtoreshës për Buxhet dhe Financa, Arbnore Uka

Në hapje të dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Arbnora Uka, falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen, edhe pse ne numër shumë të vogël dhe theksoi rëndësinë e angazhimit të tyre në procesin e planifikimit buxhetor.

Drejtoresha Arbnora Uka prezantoi Draftin fillestar të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029, duke theksuar se ky është dokumenti kryesor strategjik për planifikimin e buxhetit komunal për tre vitet e ardhshme. Drejtoresha tha që drafti i dokumentit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin e Buxhetit dhe Qarkoren Buxhetore 2027 të Ministrisë së Financave.

Drejtoresha Uka njoftoi se prioritetet kryesore të Komunës së Podujevës për periudhën 2027–2029 janë zhvillimi i infrastrukturës në qytet dhe fshatra, përmirësimi i arsimit dhe shërbimeve shëndetësore, rritja e mirëqenies sociale, mbështetja e kulturës, rinisë dhe sportit, zhvillimi ekonomik përmes përkrahjes së bizneseve dhe bujqësisë, si dhe promovimi i turizmit dhe planifikimi i qëndrueshëm urban. Ajo theksoi se këto prioritate do të shërbejnë si bazë për hartimin e buxhetit komunal, me synim ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe realizimin e projekteve me interes për qytetarët.

Gjatë prezantimit, drejtoresha Uka paraqiti edhe strukturën e Kornizës Afatmesme Buxhetore sipas limitit të parë buxhetor. Ajo bëri të ditur se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Podujevës është planifikuar në vlerë prej 35,849,048 euro për vitin 2027, 37,425,150 euro për vitin 2028 dhe 39,444,425 euro për vitin 2029. Sipas saj, pjesa më e madhe e buxhetit sigurohet nga granti qeveritar, ndërsa pjesa tjetër nga të hyrat vetanake të komunës.

Në veçanti, Drejtoresha e Financave theksoi rëndësinë e investimeve kapitale, duke bërë të ditur se për vitin 2027 janë planifikuar 9.45 milionë euro, për vitin 2028 rreth 10.57 milionë euro, ndërsa për vitin 2029 mbi 12.65 milionë euro. Ajo theksoi se këto mjete do të mundësojnë realizimin e projekteve prioritare në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe fusha të tjera me rëndësi për zhvillimin e komunës.

Në vazhdim, drejtoresha tha se arsimi mbetet një nga prioritetet kryesore të Komunës së Podujevës. Ajo bëri të ditur se, përveç grantit specifik të arsimit të ndarë nga niveli qendror, komuna ka ndarë edhe mbi 5 milionë euro shtesë nga granti i përgjithshëm komunal për këtë sektor. Sipas saj, ky investim synon përmirësimin e cilësisë së arsimit, krijimin e kushteve për shtrirjen graduale të mësimi gjithëditor dhe realizimin e investimeve të nevojshme në infrastrukturën arsimore.

Po ashtu, ajo theksoi se prioritet i veçantë i është kushtuar edhe sektorit të shëndetësisë. Përveç grantit specifik për këtë sektor, komuna ka rritur mbështetjen buxhetore edhe nga burimet e veta, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Në përfundim të fjalës hyrëse, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj. Arbnora Uka, ftoi të qytetarët të japin vërejtjet, propozimet dhe rekomandimet e tyre, duke theksuar se kontributi i qytetarëve është i rëndësishëm për hartimin final të draftit sa më gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nevojat e komunitetit.

Kërkesat / pyetjet e qytetarëve nw dëgjim:

Ekrem Rrahmani

1. Sa mjete financiare janë ndarë për shtretër të lumenjve?
2. Sa mjete financiare janë ndarë për tregun e kafshëve, sepse sipas draftit të juaj une e kam parë që keni nda vetëm 50 mijë, dhe janë shumë pak?
3. Kërkesë për vendosjen e emrave e rrugëve të planifikuara për asfaltim në sistem, do të ishte me transparente për të gjithë
4. Kërkesë për asfaltimin e rrugës së varrezave në Siboc (rrugë rreth 200 metra)

Përfundimi

Në fund të takimit palët janë njoftuar se dëgjimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029 do vazhdojnë sipas kalendarit të paraparë dhe poashtu janë njoftuar se komnetet mund ti dërgojnë të shkruara në emailat e komunës liridona.rrahmani@rks-gov.net dhe arbnore.uka@rks-gov.net.

Takimi u mbyll në ora 18:50.

Në këtë takim kontribuan me pjesëmarrje 2 persona, më gjithësej 4 kërkesa/pyetje të regjistruara.

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	2
Totali	2

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029
Salla e kuvendit të Komunës së Podujevës

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	Essem Rrahmani	Sibac	Essem Rrahmani
2.	Basim Latifi	Podujevë	Basim Latifi
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			
21.			
22.			
23.			
24.			
25.			
26.			
27.			
28.			
29.			
30.			